

VENDIM
Nr. (11-2021-8472) 1721, datë 24.12.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e përbërë prej:
Gjyqtare: Shpëtime Pitaku

asistuar nga sekretarja Migaela Mukja, në Durrës, më datë 24.12.2021, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile nr. 188/2633, datë 30.12.2020 regjistrimi, që u përket:

KËRKUES: Shoqëria tregtare “Floryhen” sh.p.k. me seli në Durrës, Rrashbull, fshati Vrin, godina 1 kat, me administrator Kristaq Prence, përfaqësuar në gjykim me autorizim nga av. Rexhë Margjeka, me nr. licence 843, anëtar i Dhomës së Avokatisë Durrës.

PALË E TRETË: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, përfaqësuar nga z. Albano Bunaci.

OBJEKTI: Hapja e procedurës së falimentit për subjektin, shoqëria tregtare “Floryhen-E” sh.p.k., me NIPT L22028501L, me seli në Durrës, Rrashbull, fshati Vrin, godinë 1-katëshe, me administrator z. Kristaq Prence.

BAZA LIGJORE: Neni 20 i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin” dhe neni 99, i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”; nenet 48, 51 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për QKB-në”, të ndryshuar; neni 451 i ligjit “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar

Gjykata konstaton kryesisht se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor sipas përcaktimeve të nenit 36 e vijues të K. Pr. Civile dhe se në bazë të neneve 41, 42 e vijues të K. Pr. Civile ajo është kompetente për shqyrtimin e saj.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të palëve ndërgjyqëse, këta kërkuar:

Pala kërkuese, shoqëria “Floryhen” sh.p.k., e përfaqësuar nga av. Rexhë Margjeka: “Jam dakord me raportin e paraqitur nga administratori i falimentit dhe mbylljen e procedurës së falimentimit.”.

Pala e tretë, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, me përfaqësues z. Albano Bunaci kërkoj shlyerjen e detyrimeve tatimore të papaguara nga shoqëria “Floryhen-E” sh.p.k.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet dhe dëgjoi pretendimet e palëve në gjykim, lidhur me çështjen civile,

VËREN:

Më datë 30.12.2020, pranë kësaj gjykate është regjistruar për gjykim çështja civile nr. 188/2633, që i përket palës kërkuese “Floryhen” sh.p.k. me objekt: Për fillimin e procedurave të falimentimit.

Shoqëria “Floryhen-E” sh.p.k. ka paraqitur kërkesë pranë kësaj gjykate me të cilën ka kërkuar fillimin e procedurave të falimentimit të kësaj shoqërie për shkak të paftësisë paguese. Së bashku me kërkesën dhe në mbështetje të saj ka depozituar në gjykatë dokumentacionin sipas kërkesës së nenit 14, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

Pas depozitimit të kësaj kërkesë gjykata e falimentit, në referim të neneve 14 dhe 17, të ligjit nr. 110/2016, shqyrton përputhshmërinë e kërkesës me nenin 14 të këtij ligji, ku pas një rishikimi të përgjithshëm të dokumentacionit vërtetohet gjendja e paftësisë paguese të debitorit.

Në rastin konkret, gjykata ka verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi së bashku me kërkesën, të cilat kanë vërtetuar paftësinë paguese të debitorit dhe për këtë shkak kjo gjykatë ka deklaruar fillimin e procedurave të falimentimit sipas nenit 29 të këtij ligji.

Ky vendim i gjykatës përmban:

Emrin e shoqërisë “Floryhen-E” sh.p.k. adresën, NIPT-in, llojin e veprimtarisë së shoqërisë;

Ka caktuar administrator të falimentit z. Luan Muça;

Ka urdhëruar që një kopje e vendimit të shkurtuar të botohet në Fletoren Zyrtare, t'i njoftohet QKB-së dhe të publikohet në faqen zyrtare të gjykatës;

Kërkesën ndaj çdo subjekti që pretendon të jete kreditor i debitorit;

Datën në të cilën do të mbahet mbledhja mbi raportin.

Ky vendim i është njoftuar administratorit të caktuar, kreditorit që ka filluar procedurat e falimentimit.

Në seancën e datës 29.10.2021, u paraqitën përfaqësues nga DRT Durrës, të cilët kërkuan ndërhyrje në gjykim, duke pretenduar se DRT Durrës është kreditore ndaj kërkuesit, shoqëria "Floryhen-E" sh.p.k., për mosdeklarim.

Kjo kërkesë u pranua nga gjykata dhe iu la si detyrë administratorit që pretendimet e DRT Durrës të përfshihen në raportin e tij.

Më datë 6.12.2021, administratori i falimentit paraqiti në gjykatë raportin mbi hartimin e listës së kreditorëve të shoqërisë "Floryhen-E" sh.p.k.

Administratori, në raportin e përgatitur prej tij, e ka hartuar listën e kreditorëve bazuar në dokumentacionin si: dokumentet e punës së kreditorit, njoftimet prej debitorit, dhe kanë rezultuar gjithsej 16 kreditor ndaj kërkuesit, si më poshtë:

1. "Besniku" sh.p.k. Kukës, me NUIS J885112011, me vlerë detyrimi 4,488,268 lekë;
2. "Shehdula" sh.p.k. Durrës, me NUIS J61827501H, me vlerë detyrimi 5,118,890 lekë;
3. "Ovital" sh.p.k. Durrës, me NUIS K02023501G, me vlerë detyrimi 5,550,000 lekë;
4. "Edipack" sh.p.k. Durrës, me NUIS J61818524A, me vlerë detyrimi 312,417 lekë;
5. "Eurokartoni" sh.p.k. Fier, me NUIS K52505401W, me vlerë detyrimi 950,087 lekë;
6. "Kastrati Grup" sh.a Durrës, me NUIS K52505401W, me vlerë detyrimi 1,789,44 lekë;
7. "MBM" sh.p.k. Kavajë, me NUIS K83807201L, me vlerë detyrimi 469,172 lekë;
8. "Vodafone Albania" s.l.a Tiranë, me NUIS Ki1715005L, me vlerë detyrimi 614,03,9 lekë;
9. "OSHEE Grup Tiranë", me NUIS K72410014H, me vlerë detyrimi 1.741,885 lekë;
10. "GLAN" sh.p.k. Durrës, me NUIS K81419510D, me vlerë detyrimi 16.200532 lekë;
11. "I.A.M." sh.p.k. Durrës, me NUIS J91524501J, me vlerë detyrimi 162,237,268 lekë;
12. "ELIED" sh.p.k. Tiranë, me NUIS K52101005V, me vlerë detyrimi 51,000 lekë;
13. "AM" sh.p.k. Durrës, me NUIS K72208502V, me vlerë detyrimi 1,333,160 lekë;
14. "MIDAC-AL" sh.p.k. Tiranë, me NUIS K716060071, me vlerë detyrimi 124,545 lekë;
15. "Ferra&Co" sh.p.k. Durrës, me NUIS J61805508W, me vlerë detyrimi 1,151,783 lekë;
16. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës:

- Detyrime 1,484,577 lekë;

- TVSH, Kreditore 10,621,516 lekë;

- Diferenca 9,173,547 lekë (kaluar afati 5-vjeçar i rimbursimit).

Në analizimin e rastit, gjykata ka parasysh nenin 73, të ligjit nr. 110/2016, i cili përcakton se:

"Afati i parashkrimit të së drejtës për të bërë vlerësim tatimor".

1. E drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 viteve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës.

2. Afati i parashkrimit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, mund të ndërpritet kur:

a) si rezultat i apelimit të vlerësimit të mëparshëm bëhet një vlerësim i ri. Në këtë rast afati i parashkrimit është më i mëvonshëm se:

i. afati i parashkrimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;

ii. 30 ditë kalendrike nga data e vendimit përfundimtar të gjykatës së apelit;

b) si rezultat i një kontrolli ose hetimi tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore, bëhet një vlerësim i ri. Në këtë rast, afati i parashkrimit është më i mëvonshëm se:

i. afati i parashkrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;

ii. 30 ditë kalendarike nga data e nxjerrjes së vendimit përfundimtar, me shkrim, të kontrollit ose hetimit tatimor;

c) ndaj tatimpaguesit ka filluar një çështje penale për detyrimet e tij tatimore. Në këtë rast, afati i parashkrimit është më i mëvonshëm se:

i. afati i parashkrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;

ii. 30 ditë kalendarike nga data e marrjes nga gjykata të vendimit të formës së prerë, për çështjen penale.

3. Në rastet kur ndaj tatimpaguesit hapet një çështje penale për detyrimet tatimore të tij, pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, e drejta për vlerësim tatimor vlerësohet se nuk është parashikuar.

Lidhur me kreditorin DRT Durrës gjykata vlerëson se, meqenëse kërkuesi shoqëria “Floryhen-E” sh.p.k. rezultoi me tvsh kreditore (të rimbursueshme) në shumën 10.621.516 lekë, por gjithashtu ka detyrim ndaj DRT Durrës në shumën 1.484.577 lekë, atëherë detyrimet kompensohen sipas nenit 75.1 të ligjit për TVSH-në.

Neni 75/1, Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore parashikon se:

“1. Personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, që rezultojnë me tepriçë kreditore, kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar tepër pranë Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kjo kërkesë paraqitet sipas formularit të miratuar “Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së”, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, verifikojnë situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miratojnë tepriçën kreditore si të rimbursueshme. Kur është e nevojshme, administrata tatimore ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut. Paga e tepriçës kreditore të rimbursueshme kryhet brenda pesë ditëve, nëpërmjet sistemit të thesarit, në bazë të rregullave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit të Financave. Në rast të kundërt, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore në masën e TVSH-së së pretenduar për rimbursim.

1/1. Në rastin kur tatimpaguesi, i cili ka kërkuar rimbursim, i nënshtrohet kontrollit, sipas analizës së riskut, me qëllim respektimin e afatit të rimbursimit, sipas këtij neni, afatet e përcaktuara nga nenet 83 dhe 84 nuk do të zbatohen, dhe çdo afat do të jetë 5 ditë kalendarike.

1/2. Përjashtimisht përcaktimeve të pikave 1 dhe 1/1, të këtij neni, në raste të veçanta, me kërkesë të administratës tatimore dhe me dakordësinë e tatimpaguesit mund të lidhet një marrëveshje për pagesë me këste, e cila përmban një plan të skeduar pagesash për detyrimet që administrata tatimore ka ndaj tatimpaguesve, si rezultat i kërkesave të miratuara për rimbursimin e TVSH-së. Në këto raste, detyrimi i administratës tatimore ndaj tatimpaguesit konsiderohet i shlyer dhe nuk aplikohen kamatëvonesat. Rastet kur do të aplikohet, procedurat dhe kriteret për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.” (shtuar me ligjin nr. 83/2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 31.12.2019).

2. Mënyra dhe procedurat e hollësishme teknike për zbatimin e pikës 1, të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave (ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014, botuar në F.Z. nr. 198, datë 30.12.2014) (ndryshuar me ligjin nr. 91/2015, datë 23.7.2015, botuar në F.Z. nr. 144, datë 7.8.2015) (ndryshuar me ligjin nr. 112/2016, datë 3.11.2016, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Ka rezultuar e provuar se shumica gjithsej e detyrimeve që ka shoqëria “Floryhen” është 202,132,890 lekë.

Aktivitetet e shoqërisë “Floryhen-E” sh.p.k. Durrës, kanë rezultuar se janë 0.

Në kushtet e mungesës së pasurisë nga shoqëria kërkuese, kur shoqëria nuk ka pasuri për të mbuluar shpenzimet, gjykata e falimentit vendos për përfundimin e procedurës së falimentimit për shkak të mungesës së pasurisë.

Kjo procedurë parashikohet nga neni 20, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentin”.

Me vendimin e datës 14.5.2021, gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës dhe nisjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë tregtare “Floryhen” sh.p.k. me qendër në Durrës, dhe ka caktuar si administrator të falimentit shtetasin Luan Muça.

Rezulton se nga administratori janë zbatuar detyrat e lëna nga gjykata në zbatim të ligjit dhe më datë 29.10.2021, nga administratori i falimentit, është paraqitur raporti “Llogaria përfundimtare e debitorit ‘Floryhen’ sh.p.k. në falimentim”.

Gjykata, pasi shqyrtoi provat e palës kërkuese në proces dhe pretendimet e palës së tretë, çmon se kërkesa është e bazuar dhe për pasojë duhet të pranohet.

Rezulton nga përmbajtja e pasqyrave financiare se për tri vitet e fundit, pala e paditur, shoqëria tregtare “Floryhen” sh.p.k. ka deklaruar rezultat me humbje të kapitaleve të veta për të paktën tri vite rresht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 126 dhe 306 e vijues të K. Pr. Civile, e në nenin 20, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, dhe nenin 99, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”; nenet 48, 51, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për QKB-në”, të ndryshuar; neni 451 i ligjit “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Floryhen- E” sh.p.k për shkak të mungesës së pasurive të debitorit (shoqërisë).
 2. Urdhërohet QKB-ja të çregjistrojë nga regjistri tregtar shoqërinë “Floryhen-E” sh.p.k. Durrës.
 3. Urdhërohen organet tatimore të çregjistrojnë shoqërinë “Floryhen-E” sh.p.k. Durrës, sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
 4. Urdhërimin e detyrimit për publikim të vendimit në internet në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të organit tatimor.
 5. Dërgimin e një kopje të vendimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dega Durrës.
 6. Shpalljen publike të vendimit dhe dërgimin e njoftimit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike, në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe në Fletoren Zyrtare.
 7. Shpenzimet gjyqësore lihen siç janë bërë.
 8. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës brenda 15 ditëve, nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar.
- U shpall në Durrës, sot më datë 24.12.2021.

GJYQTARE
Shpëtime Pitaku